



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/OPŠTINA SKENDERAJ
SKENDERAJ

Nr. No. 01-060/01-0018823/24
Data Date 16.04.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë **21.03.2024**, në ora **11:00**, në sallën e bordit të drejtorëve.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
 2. Miratimi i rendit të ditës;
 3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
 4. Propozim-vendim për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr. 02-020/01-0013489/24, të datës 12.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
 5. Propozim-vendim për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02.020/01-0013678/24, të datës 13.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
 6. Propozim-vendim për themelimin e komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale, me Nr.02-020/01-0013528/24, me Nr.13.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
 7. Propozim-vendim për themelimin e komisionit të Kuvendit Komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale, me Nr.02-020/01-0013526/24, të datës 13.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
- Pikat shtesë për këtë mbledhje;**
8. Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e projekteve kapitale, me Nr.04-400/01-0014787/24, të datës 21.03.2024, (Raporton Drejtori i DBF-së **z.Ismet Aliu**);
 9. Propozim-venim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Skenderajt për vitin 2024-2028, me Nr.12-052/01-0014807/24, të datës 21.03.2024, Raporton Drejtoresha e DZHENIT-së, **znj.Besarta Meha-Ademi**);
 10. Të ndryshme.

Kryesuesja: Të nderuar anëtar KPF-së, Kryetar i komunës, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 5 anëtarë të KPF-së, mungon me arsye Alketa Mecini.

Para miratimit të rendit të ditës i kemi dy pika shtesë për këtë mbledhje;

-Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e projekteve kapitale, me Nr.04-400/01-0014787/24, të datës 21.03.2024.

-Propozim-venim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Skenderajt për vitin 2024-2028, me Nr.12-052/01-0014807/24, të datës 21.03.2024,

Shkojmë në votim për futjen në rend dite;

-Konstatohet me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim, futet si pikë shtesë Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e projekteve kapitale, me Nr.04-400/01-0014787/24, të datës 21.03.2024, Vazhdojmë me piken tjetër, për futjen në rend dite,

-Konstatohet me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim, futet si pikë shtesë Propozim-vendim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Skenderajt për vitin 2024-2028, me Nr.12-052/01-0014807/24, të datës 21.03.2024.

-Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hapë debatin, nëse nuk ka, konstatohet me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nëse nuk ka konstatohet me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr. 02-020/01-0013489/24, të datës 12.03.2024, (Raporton);

Kryetari i Komunës, Fadil Nura; Fjala përshëndetëse, para veti e keni Propozim-vendim për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së, në përbërje prej tre anëtar, 1 anëtar nga ekzekutivi DSHMS-së, 1 anëtar nga shoqëria civile SHFD e UÇK-së, dhe 3 anëtar nga kuvendi. Detyrat e komisionit është që të bëjë shpalljen e thirrjes publike, shqyrtimin e aplikacioneve, përzgjedhjen e përfituesve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrje, si dhe propozimin për miratim në kuvend komunal.

Kryesuesja: E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Ilir Ejupi-IDEAL: Fjala përshëndetëse, fillimisht uroj që ky proces i shpërndarjeve të banesave për familjet e dëshmorëve, të jetë transparent, i rregullt pa anime politike. Për sa banesa behet fjalë në këtë fazë? Dhe në rast që në këtë komision nuk përfshihet opozita nuk do ta votojmë këtë komision, së në komisionet e mëhershme nuk kemi qenë të përfshirë, në këtë fazë e votoj, po nëse nuk përfshihem në komision si opozitë nuk do ta votoj, për shkak së është një çështje e ndihshmë që kërkon transparencë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Ilirë këto janë familje të dëshmorëve e familjet e dëshmorëve janë mbi dhe përtej politik dhe opozita mirë është më kanë në proces edhe me pa a ka transparencë, numri i banesave është 128 sipas projektit, edhe lokalet që do tu japim shoqatave për zyre.

Kryesuesja: Dikush tjetër , nëse nuk ka, Konstatohet me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr. 02-020/01-0013489/24, të datës 12.03.2024.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02.020/01-0013678/24, të datës 13.03.2024, (Raporton);

Kryetari i Komunës, Fadil Nura; Para veti e keni propozim-vendim për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, komisioni do ti ketë tre (3) anëtar nga kuvendi. Detyrat e komisionit është që të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave, brenda 15 dite tu kthejë përgjigje me shkrim parashtruesve të ankesave si dhe për punën e tij ti raportoj kuvendit të komunës.

Kryesuesja: E hapë debatin, nëse nuk ka, Konstatohet me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për themelimin e komisionit të

Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02.020/01-0013678/24, të datës 13.03.2024.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për themelimin e komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale, me Nr.02-020/01-0013528/24, me Nr.13.03.2024, (Raporton);

Kryetari i Komunës, Fadil Nura; Edhe në këtë rast e kemi një Propozim-vendim për themelimin e komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale, prej 7 anëtarëve, 4 anëtar nga kuvendi, një nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe një anëtar nga lokaliteti. Detyrat e këtij komisioni është që të bëjë koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave lokale dhe për punën e tij të raportoj kuvendit.

Kryesuesja: E hapë debatin, nëse nuk ka, Konstatohet me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për themelimin e komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për themelimin e komisionit të Kuvendit Komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale, Nr.02-020/01-0013526/24, datë 13.03.2024, (Raporton);

Kryetari i Komunës, Fadil Nura; Edhe në këtë rast e kemi Propozim-vendim për themelimin e komisionit të Kuvendit Komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale, me përbërje prej tre anëtarëve nga kuvendi i komunës. Detyrat e komisionit është që të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave, brenda 15 dite tu kthejë përgjigje me shkrim parashtruesve të ankesave si dhe për punën e tij të raportoj kuvendit të komunës.

Kryesuesja: E hapë debatin, nëse nuk ka, Konstatohet me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për themelimin e komisionit të Kuvendit Komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale.

Vazhdojmë me piken 8 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e projekteve kapitale, me Nr.04-400/01-0014787/24, të datës 21.03.2024, (Raporton);

Drejtori i DBF-së Ismet Aliu; Fjala përshëndetëse, para veti e kemi një pikë shtesë për këtë mbledhje Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e projekteve kapitale në shumë prej 90,000.00€, me rastin e aprovimit të buxhetit për vitin 2024, një pjesë e mjeteve prej 90,000.00€ kanë mbetur në rezerva dhe ligji në zbatim kërkon këto mjete të transferohen në kategorinë kapitale dhe të kalojnë në fondin e bashkëfinancimit.

Kryesuesja: E hapë debatin, fjalën ja kaloj:

Ilir Ejupi-IDEAL: Drejtor me sa po e kuptoj këto 90,000.00€ paskan qenë të parapara për projektin Vendorsja e trafove për sigurimin e ujit të pijes në BL, Likocit, çka ka me ndodh me këtë projekt a e kanë marr përsipër kompania apo çfarë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DBF-së Ismet Aliu; Ilir, ne me rastin e aprovimit të buxhetit për vitin 2024, i kemi lenë 90,000.00€ për këtë projekt, po duke e shikuar UA, po edhe ministria e ka ndaluar, për arsye së sigurimin e trafove e ka kompetencë kompania publike energjetike, dhe ata e kanë për obligim me sigurua, dhe për atë këto mjete kanë mbetur në rezerva.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, Konstatohet me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e projekteve kapitale, në shumë prej 90,000.00€.

Vazhdojmë me piken 9 të rendit ditës:

-Propozim-venim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Skenderajt për vitin 2024-2028, me Nr.12-052/01-0014807/24, të datës 21.03.2024, Raporton);
Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni si pikë shtesë Propozim-venim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Skenderajt për vitin 2024-2028, kjo strategji ka kaluar neper diskutime publike, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hapë debatin, fjalën ja kaloj:

Ilir Ejupi-IDEAL: Drejtoresh me sa e pash në këtë strategji në planifikim për vitin 2024-28 të investimet është Parku i Biznesit, a keni ndërmarr, apo ndonjë planë konkret rrethe këtij parku, për vendin së ku e keni planifikua, a banë sqarime?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi: Strategjia është një dokument bazë i cili me vonë pasohet nga shume plane ma të detajizuar, sa i përket parkut, parku që e dini në mandatin e kaluar ka kaluar në kuvend, është aty dhe me rastin që do të ketë biznese të interesuara për tu vendosur do ti ofrohet edhe infrastruktura e gatshme.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, Konstatohet me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-venim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Skenderajt për vitin 2024-2028.

Vazhdojmë me piken 10 të rendit ditës:

Të ndryshëm, a ka dikush me shtua diçka, nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit për datë do të njoftojmë me kohë, gjitha të mirat.

Procesmbajtës



Kryesuesja e Kuvendit